



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIJZA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të Nenit 35, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, në bazë të Nenit 24 dhe 28 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës, në bazë të Nenit 29 të Rregullores për rregullimin e procedurave të konkursit në RTK dhe në bazë të miratimit nga Bordi të propozimit të Ud. e Drejtorit të Përgjithshëm, Radiotelevizioni i Kosovës shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës: **Kryeredaktor në RTK Radio**

Numri i referencës: **2569**

Kohëzgjatja e mandatit: **Tri (3) vjet, me mundësi të rizgjedhjes në bazë të konkursit publik**

Kryeredaktor në RTK-Radio:

1 pozitë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Planifikon, organizon, mbikëqyrë dhe në bashkëpunim me Drejtorin e RTK Radios, koordinon tërë procesin e punës në sektorin programor të RTK-Radios, në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin dhe Kodin etik të gazetarisë në RTK;
- Harton dhe zbaton planin vjetor programor të RTK Radios;
- Përgatit raporte periodike dhe vjetore lidhur me përmbushjen e planit vjetor programor;
- Zbaton normativat dhe standardet programore;
- Është përgjegjës për tërë përmbajtjen programore të RTK Radios;
- Koordinon punën e redaktorëve përgjegjës, dhe nëpërmjet tyre redaktorëve në të gjitha programeve e RTK-Radios;
- Propozon dhe zbaton strategjinë zhvillimore për programet e RTK Radios;
- Projektet për emisione të reja programore, me përqindje paraprakisht të përcaktuara të dëgjueshmërisë, ia propozon Drejtorit të RTK-Radios;
- Mban përgjegjësinë editoriale të programit, sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Bashkëpunon për përgatitjen e planeve për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit programor;
- Mban takimet për biseda të rregullta vjetore me bashkëpunëtorët e vet;
- Përgatit kushtet organizative për aftësim të stafit programor;
- Përcjellë njohuritë profesionale te bashkëpunëtorët;
- Është bashkëpërgjegjës për zhvillim dhe avancim profesional për bashkëpunëtorët.

I përzgjedhuri, për punën e vet në cilësinë e Kryeredaktorit për RTK-Radio, i raporton dhe i përgjigjet Drejtorit të RTK-Radios.

Kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta:

Kushtet dhe kriteret e përgjithshme të cilat duhen plotësuar nga kandidati me rastin e aplikimit janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë së paku përvojë pune profesionale tetë (8) vite, prej të cilave së paku katër (4) vite përvojë punë në udhëheqje të diskut informativ ose pozita të tjera menaxheriale në nivel të programit mediatik;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;
- Të ofrojë dëshmi që në kohën e aplikimit, nuk janë duke u zhvilluar hetime penale ndaj tij;
- Të mos mbajë post publik të zgjedhur (funksionarët publik);
- Të mos ketë qenë deputet, ministër, zyrtar i lartë i pushtetit qendror e lokal apo anëtar i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tri (3) viteve të fundit;
- Të mos ketë angazhime biznesi ose çfarëdo lloj çështjeje, të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi, i paraparë në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
- Të ketë integritet të lartë profesional dhe moral.

Përveç kushteve të përgjithshme të cekura më lart, kandidati duhet të plotësojë edhe këto kushte dhe kritere të veçanta:

- Të ketë kualifikim universitar;
- Të ketë njohuri të shkëlqyer të spektrit medial në Kosovë dhe më gjërë;
- Të ketë aftësi të dëshmuar të organizimit, planifikimit dhe udhëheqje të punës së ekipeve editoriale;
- Të ketë aftësi të dëshmuar në organizim, udhëheqje dhe planifikim;

- Të ketë njohuri të avancuar dhe të përditësuar të punës me kompjuter;
- Të zotërojë ndonjëherë nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, në të folur dhe në të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar është e preferueshme;
- Të ketë aftësi për caktimin e prioriteteve dhe punë ekipore si dhe për të punuar në mënyrë efektive nën presion kohor;
- Të ketë aftësi për të bashkëpunuar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë.

Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- a. **Formulari për aplikim** (*Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni në ueb-faqen e RTK-së në këtë vjeggëz: <https://www.rtklive.com/sq/page.php?ID=19>*)
- b. **Curriculum Vitae (CV)** (*Dokumenti në fjalë – CV, Biografi, Rezime – duhet të jetë i aktualizuar dhe duhet të përmbajë informacion të detajuar rreth të dhënave personale, shkollimit/edukimit, trajnimeve, përvojës së punës, aftësive profesionale, aftësive të buta, ose çfarëdo informacioni tjetër që konsiderohet se e pasuron dosjen e aplikimit*).
- c. **Dëshmitë e kualifikimit universitar** (*Diplomat e fituara brenda vendit duhet të jenë të noterizuara, kurse diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga organet kompetente të Republikës së Kosovës*).
- d. **Një kopje të letërnjoftimit ose të pasaportës valide** (*Dokumenti i identifikimit duhet të jetë i lëshuar nga Republika e Kosovës, duke dëshmuar kështu shtetësinë e aplikuesit*).
- e. **Dëshmia e përvojës së punës profesionale së paku 8-vite, prej të cilave së paku 4-vite në udhëheqje të diskut informativ ose pozita të tjera menaxheriale në nivel të programit mediatic** (*Dëshmimi i përvojës së punës duhet të bëhet nëpërmjet kontratave të punës ose vërtetimeve të punës të lëshuara nga punëdhënësit mbi marrëdhënien e punës. Dokumentet e dorëzuara duhet të japin informacion eksplicit lidhur me pozitën menaxheriale dhe kohëzgjatjen e ushtrimit të asaj pozite. Përvoja e punës menaxheriale konsiderohet pozitive e punës që ka nën menaxhim një nga aspektet, si numër të caktuar punonjësish, projekte, procese të ndryshme, buxhet financiar ose një kombinim të tyre, e këto informata nëse nuk gjenden në kontratat e punës, duhet të dëshmohen nga vërtetimi i punës i lëshuar nga punëdhënësit*).

f. **Dy letra referuese profesionale.**

g. **Certifikata që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime dhe certifikata që dëshmon se aplikuesi nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale sipas kriterëve të konkursit** (*Certifikatat që dëshmojnë se aplikuesi nuk është nën hetime dhe që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale apo nuk ka një të kaluar kriminale duhet të merren në Policinë e Kosovës dhe gjykatën kompetente. Certifikatat duhet të jenë jo më të vjetra sesa data e publikimit të konkursit*).

Kërkesë shtesë:

Bashkëngjitur me dokumentacionin e lartshënuar, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një **Koncept zvillimor, programor dhe editorial** lidhur me synimet zhvillimore të programit në **RTK Radio**. Mes tjerash, dokumenti në fjalë duhet t'i plotësojë këto kërkesa:

- Të shkruhet dhe të përpilohet në formatin e Strategjisë Zhvillimore që do të zbatohet gjatë mandatit tre (3) vjeçar;
- Të paraqesë sfidat dhe problemet kryesore të programit të RTK Radio, duke ofruar zgjidhje për secilën prej tyre.
- Dokumenti konceptual mund të dorëzohet në versionin e shkurtuar dhe përmbledhës (maksimum 5 faqe), përderisa i njëjti pastaj mund të zgjerohet dhe plotësohet për t'u prezantuar në detaje gjatë procesit të intervistës.

Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit/aplikacionit

Dokumentacioni i kërkuar me konkurs publik duhet të dorëzohet fizikisht në zarf të mbyllur, në zyrën e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, nr. 71, në ndërtesën e Radiotelevizionit të Kosovës, rr. "Xhemajl Prishtina", nr.12. Prishtinë, Republika e Kosovës.

Data e fundit e pranimit të aplikacioneve është **08.08.2024**, ora **16.00**.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe kohës së paraparë me konkurs publik nuk do të pranohen.

Mënyra e vlerësimit të aplikacioneve

Procedurat, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së Kryeredaktorit, janë të sqaruara në Rregulloren për rregullimin e procedurave të konkursit në RTK, e cila është e qasshme përmes këtij linku:

<https://www.rtklive.com/sq/docs/archive/767.pdf>

Informacion shitesë:

Emërtimet në këtë konkurs janë neutrale sa i përket gjinisë dhe nënkuptojnë edhe gjininë tjetër. Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni, përveç emrave dhe mbiemrave të kandidatëve, do të trajtohen sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

RTK siguron që procedurat e përzgjedhjes janë të hapura, ofrojnë konkurrencë jodiskriminuese, objektive dhe transparente, si dhe i gjithë procesi i përzgjedhjes është transparent.

Procesi i rekrutimit mund të monitorohet nga monitorues të jashtëm, me njoftim paraprak (se paku 24 ore), drejtuar kryetarit të komisionit përmes e-mailit zyrtar: administrata@rtklive.com

Për informata të tjera, kontaktoni zyrën e Administratës të RTK-së në numrin +383 (0) 38 230 102